

KËRKESË
Nr. 2629, datë 8.8.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT “AMARILDO ADEMI”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“AMARILDO ADEMI”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT -TR-2019-000509-5

Datë: 12.6.2019

Bazuar në nenin 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit, nr. ISHMPUT-TR-2019-000509-2, datë 31.5.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Amarildo Ademi”, NIPT: L16613201M, përfaqësues i autorizuar i subjektit “Amarildo Ademi”, prej datës 31.5.2019, 12:00 deri më datën 31.5.2019, 16:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë 31.5.2019 dhe e njoftoi në datë 31.5.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligj nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 32, pika 1/e.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit Nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 5000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Subjekti të izolojë burimin e zhurmës duke marrë masat parandaluese dhe mbrojtëse me qëllim zbatimin e udhëzimit nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufij të zhurmave në mjediset e caktuara”, si dhe të dërgojë informacion pranë ISHMPUT-së Tiranë mbi masat e marra për korrigjimin e shkeljes së konstatuar.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

-

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Genci Hicka ID: 0301020016

Merifa Abedini ID: 0301020031

Kundër vendimit përfundimtar, subjekti: Amarildo Ademi, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.